

**OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I RRUGES
RRESHEN – FSHATI SHESHAI**

Punoi: *ing. gjeo. Leonard Kazanxhi*

per: *"ERALD-G" sh.p.k.*


ing. Gezim Islami

PËRMBAJTJA

- 1. HYRJE**
- 2. NDËRTIMI GJEOLOGJIK I RAJONIT**
- 3. TEKTONIKA**
- 4. SIZMICITETI**
- 5. PËRSHKRIMI I PUNIMEVE**
- 6. PARAMETRAT**

1. HYRJE

Rruga e fshatit Sheshaj ndodhet në gjendje tejte të amortizuar. Rruga ka shtresa pothuaj inegzistente duke krijuar një vështirësi tepër të madhe për qarkullimin e mjeteve. Kjo përben një disavantazh shumë të madh për banorët e fshatit, duke e bërë pothuajse të pamundur zhvillimin e aktiviteteve të perditshme të tyre si bujqësia, turizmi etj. Për këtë gjë është kërkuar nga Bashkia Mirdite të zhvillohet projekti i rikonstruksionit të rruges që lidh qytetin Rreshen me fshatin Sheshaj, duke krijuar një gjurmë të rruges me parametra gjeometrike të rregullt, dhe nga ana strukturore shtresa e nenshtresa që të përballojnë trafikun që krijohet në këtë vijë kalimi.



2. NDËRTIMI GJEOLOGJIK I RAJONIT

Nga pikëpamja e ndërtimit gjeologjik ne zonen tone dhe perreth bejne pjese keto formacione gjeologjike.

➤ Kretaku i sipërm (Cr2)

Këto depozitime takohen në të gjitha strukturat karbonatike të zbuluara në sipërfaqe, duke filluar nga strukturat e Renc-Kakariqit në veri, në të Dajtit, Makareshit, Letan, Tervoll, Tomorr-Kulmak deri në Melesin (Leskovik) në jug. Në strukturat e nënzonës së Dajtit (Renc, Kakariq, Dajt, Makaresh, etj), pjesa e poshtme e prerjes përfaqësohet nga dolomite me ndërthurje gëlqerorësh dolomitike, që përmbajnë në disa shtresa dhe rudiste. Më sipër prerja predominohet nga gëlqerorë dolomitike, me ndërthurje më të rralla dolomitësh masive. Në prerjen më të sipërme takohen dolomite me ndërthurje gëlqerorësh bioklastike shtresë-trashë. Ndërmjet dolomiteve dhe gëlqerorëve dolomitike në disa prerje (Tujan, Vaje etj.) takohen shiste të holla bituminoze.

➤ Paleocen- Eoceni (Pg1-2)

Paleocen-Eoceni është veçuar vetëm në rajonet, nga Guri i Topit në jug deri në atë të Manatise (Lezhe) në veri, ku është realizuar hartografim gjeologjik i detajuar. Përfaqëson pjesën e sipërme të “flishit të ri”. Duke qënë se vendosen suksesivisht mbi flishin e Maastrikiantit të sipërm, kanë dhe të njëjtën fushëpërhapje gjeografike e strukturale me depozitimet e Kretakut të sipërm.

Litologjikisht këto depozitime janë shumë të ngjashme me ato të Maastrikiantit të sipërm. Ato përfaqësohen nga flish e flishoide, kryesisht ranoro-alevrolitore, të alternuar, me ranore shtresë-trashë deri masive, horizonte vidhisës e konglomerate. Gjithashtu në prerje dallohen edhe dalje në formë të thjerrzave të zgjatura të gëlqerorëve argjilore-mergelore dhe shtresa gëlqerorësh turbiditike gri në bezhë, në të cilat janë të grumbulluara foraminiferet planktonike.

Karakteristikat litologjike të shkëmbinjve makroskopikisht janë të përafërta me ato të Maastrikiantit të sipërm, vetëm kemi shtimin në prerje të përbërësit ranor si në sasi dhe në trashësi të shtresave. Veçori tjetër dalluese me flishin e flishoidet e Maastrikiantit të sipërm është se krahas ndryshimeve litologjike në hapësirë e kohe në prerjen paleogjenike, shtresat e gëlqerorëve takohen rrallë deri në mungesë të plotë, shtohet në prerje prezenca e komponentit konglomerat me shtresa deri potente që janë dhe treguesit për praninë e ndryshimeve litologjike të tyre si në shtrishmëri ashtu dhe në prerje vertikale. Ndërsa nën mikroskop në ranorët, në dallim nga ranorët e Maastrikiantit, rritet përmbajtja e coprizave të shkëmbinjve ofiolitike dhe në raste të rralla sasia e materialit serpentiner-spilitik arrin edhe të mbizotërojë. Gjithashtu ranoret e Paleogenit kanë përmbajtje më të lartë karbonaciteti (20-25 %) se ranoret e Maastrikiantit. Në horizontet vidhisës dhe konglomeratet takohen zaje copa, popla e blloqe të ardhur nga shkëmbinj sedimentare të Titonian-Beriasianit, Albion-Turonianit, Kretakut të sipërm, dhe Paleogenit si dhe të Liasikut të vetë zonës tektonike të Krasta-Cukalit, pa

përrjashtuar edhe të zonave tektonike të tjera. Kompleksi faunistik i parashtruar gjatë përshkrimit të depozitimeve të rajonit Ostrovic është identik edhe për rajonet e tjerë të nënzonës Krasta dhe që argumenton praninë e moshës Paleocen-Eocen. Trashësia e këtyre depozitimeve varion në diapazon të gjerë 1000-2000m, ndërsa vetë Ypresiani arrin në 700m.

➤ Eoceni (Pg2)

Këto depozitime vendosen me mospajtim stratigrafik mbi depozitimet e Paleocenit (Dajt) apo Kretakut të sipërm (Renc, Kakariq, Makaresh, etj.). Në pushimin stratigrafik pothuajse gjithkund takohet një nivel boksit-mbajtës i ndjekshëm në sipërfaqe. Trashësia e depozitimeve të Eocenit luhetet nga 120 m në Dajt, 250m në Tervoll, 150m në Melesin, 145m në Tomorr dhe 195m në prerjen e Dëvrisë.

➤ Oligocen i poshtëm (Pg13)

Në zonën e Krujës, depozitimet e Oligocenit të poshtëm shtrihen në të dy krahët e strukturave të Rencit e Kakariqit (në veri), vazhdojnë në krahun lindor të Makareshit dhe të antiklinalit të Dajtit. Në vazhdimin jugor ato takohen në sinklinalin e Gramshit, në krahun lindor të antiklinalit të Tervollit, duke vijuar në jug deri në Leskovik. Ashtu si në zonën Jonike, edhe në këtë zonë pjesa e poshtme përfaqësohet nga pakoja mergelore kalimtare, me përbërje litologjike pothuajse të njëjtë. Në strukturat nga Tervolli e më në veri vërehet mungesa e pjesës së poshtme të pakos mergelore, duke u vendosur gradualisht drejt veriut edhe argjilat mergelore me pushim mbi gëlqerorët eocenike (prerja e Luarzës etj.).

Mbi depozitimet e flishit të hollë argjilo-ranor vijon suksesivisht flishi ranoro-argjilor me horizonte vithisës, konglomerate, olistostroma etj. Këto depozitime pësojnë ndryshime të theksuara litologjike në shtrirje. Vithisjet nënujore zvogëlohen nga jugu drejt veriut. Kështu p.sh. në prerjet e rajoneve jugore të zonës së Krujës dallohen vithisje të fuqishme me olistolite gëlqerorësh.

Në pjesën veriore të zonës së Krujës, në rajonin e Bushatit, i gjithë Oligoceni i poshtëm përfaqësohet nga flishi ranoro-argjilo-konglomeratik i ndarë në disa pako litologjike me trashësi të përgjithshme që i kalon 2100m.

➤ Holoceni (Qh)

Depozitimet e Holocenit kanë përhapje të gjerë në Shqipëri. Në këtë seksion takohen pothuaj të gjitha tipet gjenetike si ato kontinentale, ato ndërmjetëse dhe ato detare. Më të përhapura janë depozitimet aluviale, të cilat kanë mbushur pothuajse terësisht Ultësirën Adriatike nga Mbishkodra deri në afërsi të Vlorës. Përhapje të konsiderueshme kanë edhe tipet e tjerë gjenetike, si ato proluviale, eluviale e deluviale, kënetore e liqenore, lagunore e detare, të cilat më poshtë do t'i përshkruajmë më hollësisht. Seksioni i Holocenit çdo ditë e mëtepër po detajohet dhe po ndahet në dy kate, në Holocenin e hershëm dhe në Holocenin e vonshëm, që shpesh emërtohet dhe si Holoceni historik. Këtë emërtim e ka marrëpasi në këtë kat ka filluar të dallohen edhe gjurmët e qytetërimit njerëzor. Në vendin tonë nga punimet e fundit janë veçuar formacione të Holocenit të hershëm nëpërmjet studimit të sporopoleneve dhe përcaktimit të moshës absolute dhe fosileve që do të trajtohen në kapitullin përkatës si dhe Holoceni i vonshëm, (historik) kryesisht i bazuar në të dhënat arkeologjike. Pavarësisht ng

Të dhënat e fituara, Holocenit do të trajtohet i pa ndarë dhe zonat ku janë marrë të dhënat do të trajtohen më të zgjeruara.

a) Depozitimet aluviale

Ato kanë përhapje të gjerë në zonat e ulëta, në rrjedhjet e mesme të lumenjve, shpesh edhe në rrjedhjet e sipërme. Në rrjedhjet e mesme dhe të sipërme, ato formojnë depozitimet e teracave të shtratit si dhe depozitimet e sotme të shtratit, të cilat i përkasin Holocenit të vonshëm. Këto depozitime kanë qënë dhe janë objekt i shfrytëzimit të inerteve, pasi kryesisht përfaqësohen nga zhavorre, zhurre dhe rëra. Këto depozitime i takojmë në të gjithë lumenjtë tanë, duke filluar nga Drini e Gjadri, në Mat e Droje, në Zezë e Tërkuzë, lumi i Tiranës e Erzeni, në Shkumbin, në Devoll e Osum, Vjosë e deri në lumin e Pavllos në rrethin e Sarandës. Përhapjen më të madhe depozitimet aluviale e kanë në fushat e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Lushnjes e Vlorës, fushës së Korçës e Bilishtit, të fushës së Dropullit, të fushës së Vurgut e tjera, të cilat kanë marrë edhe emërtimin fushat aluviale. Në rrethin e Shkodrës (Bushat, Bregu i Bunës, Kosmaç, Zadrimë e deri në Lezhë) takohen depozitime aluviale të Holocenit. Ato kanë trashësi nga disa metra deri në 20-30 m të vendosura po mbi depozitimet aluviale të Pleistocenit, të përfaqësuara kryesisht nga zhavorret. Këto depozitime shpesh herë ndërthuren me depozitimet kënetore të formuara në të dy anët e shtratit të lumit. Depozitimet aluviale të luginës së Kirit (niveli i teracës së parë) janë përcaktuar si të Holocenit të hershëm, gjithashtu dhe ato të formuara nga lugina e Drinit, dhe të Gjadrit konsiderohen po si të Holocenit të hershëm. Këto përfaqësohen, në pjesën e poshtme nga zhavorre dhe gradualisht duke kaluar më sipër ato bëhen më të imta deri në alevrite e argjila. Këto të fundit më tepër përfaqësojnë depozitimet aluviale të derdhjeve qëkanë qënë tipike në zonën e ulët.

Lugina e Drinit gjatë Holocenit ka ndryshuar disa herë drejtimin. Drini ka kaluar pranë qytetit të Lezhës, në grykën e Gjonlulit nëpërmjet Kosmaçit dhe së fundi në luginën e Bunës. Në fushën e Lezhës takohen depozitimet aluviale, por ato janë relativisht më të reja se ato që takohen në fushën e Shkodrës dhe të Mbishkodrës.

b) Depozitimet proluviale

Këto depozitime përhapen gjerësisht si në zonat e ulëta ashtu dhe në zonat e larta, përgjithësisht përfaqësojnë depozitimet e formuara nga përrenj që derdhen në luginat e lumenjve kryesorë, të përrenjve që përshkojnë zonat fushore dhe ato bregdetare. Kryesisht ato janë të sotme dhe kanë formën e freskoreve deri në formën e koneve të rrjedhjeve. Si më tipikja e këtyre formacioneve do të përmendim konin e fundit të Përroit të Thatë në zonën e Koplikut, ku depozitimet e tij ndërthuren me ato liqenore të liqenit të Shkodrës. Vlen të theksohet që shpesh këto formime ndërthuren me depozitimet aluviale. Depozitimet proluviale i takojmë në luginën e Shushicës, të Osumit, të Shkumbinit e të Drinosit si dhe në gropat e brendshme. Ato kanë përbërje të thjeshtë, në varësi nga litologjia e zonave që shplahen. Trashësia arrin deri në 30-40m.

c) Depozitimet, deluviale dhe koluviale

Në Hartën gjeologjike të shkallës 1:200 000 kryesisht janë dalluar formimet koluviale, të cilat në mjaft raste i përkasin një diapazoni më të gjerë (së paku nga Pleistoceni i vonshëm deri

mësot). Ato i takojmë pothuaj në të gjitha këmbët e shpateve të kodrave dhe maleve, sidomos në ato që përbëhen nga terigjene dhe flishore (relativisht të pa qëndrueshëm ndaj agjentëve atmosferike). Mjaft të përhapura janë formimet eluviale dhe deluviale, të vendosura në rrafshinat malore dhe pothuaj në të gjithë shpatet. Nga formimet eluviale në ato deluviale kemi gjithmonë kalime të doradorshme. Vlen të theksohet se këto tipe formacionesh nuk janë vlerësuar, pasi ato në rilevimet gjeologjike janë konsideruar si pengesë dhe kudo janë zhveshur. Kështu që edhe të dhënat për formimet eluviale dhe deluviale, madje dhe për formacionet e tjera të Kuaternarit, janë të kufizuara.

d) Depozitimet kënetore dhe liqenore-kënetore

Depozitimet kënetore dhe ato liqenore e liqenoro-kënetore kanë përhapje të gjerë përgjatë Ultësirës Adriatike dhe nëzonat fushore të gropave të brendshme. Nga më tipiket do të përmendim depozitimet kënetore të Maliqit, nëÇukë të Sarandës, në Domosdovë, në Bytyç, në luginën e Vajkalit, etj; si dhe ato të Ultësirës Adriatike, duke filluar nga ato liqenore në zonën e Koplikut, në Kakariq të Lezhës, në Thumanë, në Tërbuf e Karavasta të Lushnjes, në Mbrostar e Seman të Fierit, në Nartë etj. Karakteristika e përbashkët e këtyre formacioneve është prania në to e torfave dhe një materiali të bollshëm organik si dhe ndërthurja e shtresave të argjilave, alevriteve, rërave e zhureve.

Vlen të theksohet se depozitimet kënetore të Kakariqit, me trashësi rreth 10 m vendosen mbi depozitimet detare të Holocenit. Po e njëjta situatë është dhe në depozitimet kënetore të Karavastasëe Semanit. Depozitimet kënetore të Tërbufit kryesisht vendosen mbi depozitimet aluviale të Holocenit të poshtëm dhe të Pleistocenit të vonshëm.

e) Depozitimet lagunore

Në zonën litorale të detit Adriatik janë të përhapura depozitimet lagunore, që janë depozitime ndërmjet atyre kontinentale dhe detare. Ato takohen pranë deltave të lumenjve kryesorë të vendit tonë. Kështu nga veriu në jug takojmë depozitimet lagunore të Velipojës, depozitimet lagunore të Lezhë-Milotit, në Durrë, Divjakë, Topoje, Boçovë e Nartë. Karakteristika kryesore e këtyre depozitimeve është mungesa në to e lëndëve organike dhe prania e faunës detare (të ujrave të kripura). Ato përfaqësohen nga ndërthurje shtresash argjilore, alevritore e rërash. Kanë trashësi deri në 10-15m. Si depozitime ndërmjetëse përcaktohen dhe depozitimet deltore, të cilat aktualisht i shohim në deltat e lumenjve kryesorë të vendit tonë.

f) Depozitimet detare

Në vendin tonë kanë përhapje përgjate bregdetit Adriatik. Ato dalin në sipërfaqe pranë vijës bregdetare deri në disa qindra metra në drejtim të kontinentit, pastaj ato shtrihen poshtë depozitimeve lagunore, aluviale e kënetore. Ato kanë trashësi nga disa metra deri në 100m në drejtim të detit. Përfaqësohen kryesisht nga rëra të madhësive të ndryshme. Me depozitimet detare janë të lidhura dhe shkrifërimet detare të plazheve të sotme, por edhe ato të mbuluara në brendësi të kontinentit. Vlen të theksohet që në fillimet e Holocenit të vonshëm (rreth 5 000 vjet më parë) deti Adriatik kufijtë i ka patur më të shtrirë.

3. TEKTONIKA

Nga pikëpamja tektonike zona jonë në studim kryesisht bën pjesë në Zonën e Krujës (Nën-zona e Dajtit) si dhe pjesërisht në Zonën e Kraste-Cukalit (Nën-zona e Krastës). Më poshtë po japim një përshkrim nga ana tektonike të këtyre zonave.

Zona e Krujës. Zona e Krujës përfaqëson një kurrizore që kufizohet në lindje me zonën tektonike të Kraste-Cukalit, ndërsa në perëndim me zonën Jonike dhe zonën e Adriatikut Jugor. Gjatë gjithë kufirit tektonik lindor, vërehet branisje e flisheve dhe rrallë herë edhe gëlqerorëve globotrunkanike të nënzonës së Krastës mbi flishin oligocenik të zonës së Krujës. Kontakti me zonën e Adriatikut Jugor dhe zonën Jonike nuk është kudo i qartë dhe i prerë. Ky kufi është i diskutueshëm sidomos për pjesën jugore (nga antiklinali i Tomorrit e më në jug).

Zona tektonike e Krujës, në të gjitha studimet e realizuara deri tani, është trajtuar si një zonë e vetme nga Leskoviku në jug, deri në Shkodër në veri. Disa studiues (Misha, etj. 1982, etj.) mbështetur në praninë e foraminifereve planktonike në depozitimet pelagjike të Kretakut në antiklinalin e Melesinit, e kanë trajtuar këtë të fundit si njësi të zonës Jonike. Studimi tematik për deshifrimin biostratigrafik të depozitimeve karbonatike të zonës së Krujës (Koroveshi, etj. 1999) solli të dhëna të rëndësishme biostratigrafike të cilat tregojnë për ndryshime të theksura të facies karbonatike nga veiu në jug. Në pjesën veriore, në të gjitha prerjet stratigrafike të kryera në depozitimet karbonatike rezultojnë vetëm foraminifere bentosike, që janë tipike për facien neritike. Këtu bën përjashtim struktura më perëndimore, ajo e Ishmit, ku nga analizat e kryera në kampionet e marra në pusin Ish.1. ka rezultuar faunë e përzjerë, e cila interpretohet si kalimtare për në zonën Jonike (Nakuçi etj. 2001). Në jug, në antiklinalin e Tomorrit, në depozitimet e Kretakut të sipërm janë takuar foraminifere planktonike krahas atyre bentosike, po kështu dhe në Kulmak e Qeshibesh, (shih kap. e stratigrafisë) dhe sidomos në Melesin ku takohen vetëm foraminifer planktonike.

Duke analizuar kohën e rudhaformimit, facien e depozitimeve karbonatike dhe stilin tektonik vihet re qartë një ndryshim i dukshëm ndërmjet strukturave në rajonet nga Elbasani e më në veri nga ato më në jug. Në veri të Elbasanit strukturat janë lineare, kryesisht izoklinale, me facie neritike, të karakterizuara nga prania e foraminifereve bentosike, me moshë të orogjenezës në fund të Oligocenit të hershëm. Ndërsa strukturat në pjesën jugore janë të natyrës antiklinale ose brahiantiklinale me facie të përzjerë, me fenomene paleogeografike dhe me moshë më të vonshme të orogjenezës (në fund të Oligocenit të mesëm). Ky dallim esencial interpretohet si efekt i ndikimit të tërthores Vlorë – Elbasan - Dibër, në jug të së cilës ndërtimi tektonik kondicionohet dhe nga prania e prishjeve të tjera tërthore dytësore dhe tektonikës kripore. Nisur nga veçoritë e mësipërme, për të evidentuar më mirë ndërtimin tektonik të kësaj zone, përshkrimin tektonik të saj do ta bëjmë sipas dy nënzonave tektonike të kondicionuar nga thyerja e thellë tektonike e lindur që në kohën e riftëzimit të Albanideve të Jashtme.

Nën-zona e Dajtit. Përfshihen rajonet në veri të tërthores Vlorë – Elbasan - Dibër. Karakteristikë dalluese për këto rajone është prania e disa linjave strukturore me struktura lineare të zgjatura me qafa ndarëse të zbehta, me krahë perëndimoreë të përmbysur e të

shkëputur tektonikisht dhe shkallë mbihypëse rritëse nga linjat lindore në ato perëndimore. Morfologjikisht strukturat e linjës lindore janë më të ngritura se ato të linjave perëndimore. Gjithashtu vërehet shuarja graduale e linjave antiklinale nga veriperëndimi drejt juglindjes. Në strukturat e këtij rajoni është i pranishëm pushimi midis depozitimeve të Eocenit dhe Kretakut të sipërm që shpesh shoqërohet me praninë e mineralit të boksitit. Facia e depozitimeve karbonatike është tipike neritike. Siç e theksuam më lart këtu bën përjashtim struktura më perëndimore e kësaj nënzone.

Në këtë nënzonë, duke u mbështetur nga të dhënat e kompleksit gjeologo-gjeofizik të shpimit të puseve dhe studimeve sipërfaqësore, dallohen disa linja antiklinale të cilat nga perëndimi në lindje janë:

Linja antiklinale Mëzez-Ishëm

Linja antiklinale Fushë Krujë-Tiranë

Linja antiklinale Renc-Makaresh-Kozan

Linja antiklinale Kakariq-Dajt-Letan

Pjesa më e madhe e kësaj nënzone mbulohet transgresivisht nga depozitimet mollasike të Serravalian – Tortonian – Mesinianit, që përfaqësojnë depresionin e Tiranë– Ishmit, i cili drejt veriut shtrihet edhe nën ujrat e detit Adriatik. Kontakti me zonën tektonike më perëndimore është tektonik në perëndim të linjes antiklinale të Ishmit. Më në jug kjo prishje, që është njëkohesisht dhe prishja e orogjenit të zonës Kruja, vazhdon në perëndim të antiklinalit të Tiranës dhe akoma më në jug në perëndim të antiklinalit të Kozanit.

Nga të dhënat seismike dhe të puseve të shpuar, rezulton se ndërtimi tektonik i të dy linjave antiklinale perëndimore Mëzez – Ishëm dhe F. Krujë – Tiranë, që mbulohen nga mollasat, është analog me atë të dy linjave lindore.

Kulmet e strukturave janë të eroduara deri në nivelin e dolomiteve të Kretakut të sipërm, ndërsa krahët e tyre ndërtohen nga depozitimet e Eocenit të sipërm – të mesëm, të vendosur me pushim stratigrafik mbi gëlqerorët dolomitik të Kretakut të sipërm. Krahët perëndimor janë të këputur nga shkëputje tektonike të tipit mbihypës dhe me sharnier të strukturës që zhytet në drejtim të jugut. Në perëndim të linjës së Ishmit interpretohet një linje antiklinale më e zhytur dhe e maskuar nga e para si rezultat i mbihedhjes së saj drejt perëndimit. Ashtu siç e theksuam më lart, vazhdimi jugor i të dy linjave perëndimore nga të dhënat e deritanishme është i pa qartë dhe mjaft i diskutueshëm. Megjithatë një fakt vihet re se, gjerësia e kësaj nënzone nga veriu në jug vjen duke u ngushtuar. Nga punimet e kompleksit gjeologo-gjeofizik dhe pusët e shpuara, rezulton se linja antiklinale Fushë Krujë-Tiranë vazhdon në drejtim të veriut në mënyrë të pa ndërprerë nën mollasat e Ultësirës edhe në det, në perëndim të antiklinalit të Rencit dhe që është vërtetuar nga disa puse të shpuar në rajonin e Pulajt. Në drejtim të jugut kjo linjë antiklinale vazhdon deri në afërsi të Petrelës. Më në jug situata gjeologjike vështirësohet shumë dhe nga të dhënat e deri tanishme të kompleksit nuk është krijuar një ide e qartë për vazhdimin e nivelit të gëlqerorëve.

Linja antiklinale Renc-Makaresh-Kozan ndodhet në lindje të linjës antiklinale tëpërsishkruar më sipër, duke u ndarë nga ajo nëpërmjet një sinklinali të ngushtë dhe të thellë. Struktura e Rencit zhvishet në sipërfaqe në veri të qytetit të Lezhës me depozitimet e

Kretakut të sipërm, të cilat ndërtojnë dhe bërthamën e kësaj strukture. Ky antiklinal ka ndërtim izoklinal, me krah perëndimor të përmbysur, gjë që vërehet mirë sidomos nga prania e gëlqerorëve eocenike në të dy anët e dolomiteve, me rënie lindore me kënde 50-55° (Nakuçi, etj. 1979). Më në jug vijon antiklinali i Makareshit, pjesa më e madhe e të cilit është e mbuluar transgresivisht nga mollasat e depresionit Tiranë-Ishëm. Më në jug sipas të dhënave të kompleksit dhe puseve të thellë të shpuar kjo linjë vazhdon me antiklinalin e Kozanit, i cili përfaqëson një strukturë më të zhytur me disa shkëputje tërthore dhe gjatësore. Prania e ujrave termale në pusët e shpuar në këtë strukturë tregon për ekzistencën e evaporiteve në afërsi të saj. Në sipërfaqe struktura e Kozanit nuk reflektohet pasi ajo maskohet nga transgresioni i depozitimeve të Burdigalianit.

Zona e Kraste-Cukalit. Zona e Kraste - Cukalit takohet si në veri të tërthores Shkodër - Pejë (Albanidet veriore), ashtu dhe në jug të saj (Albanidet jugore). Në Albanidet jugore ajo përfaqësohet kryesisht nga nënzona e Krastës, e cila shtrihet në trajtën e një brezi me drejtim dinarik (JL-VP), nga Leskoviku në jug deri në Shkodër në veri. Një dritare tektonike e kësaj nënzona takohet në Korridorin e Shëngjergjit (njësia e Okshtunit). Në sektorët veriore nga Lezha në Gurin e Zi dhe Lisnë, është veçuar njësia e Lisnë - Spitenit që shquhet sidomos për prerjet më të reduktuara (~70m) të depozitimeve jurasike e kretake.

Në Albanidet veriore, në veri të tërthores Shkodër - Pejë, zona e Krasta - Cukalit degëzohet, në drejtim të verilindjes përfaqësohet me nënzonën e Cukalit dhe në drejtim të veriperëndimit, në trajtën e një brezi të ngushtë, në jug të Taraboshit duke u lidhur përtej kufirit me zonën e Budvës, në Malin e Zi.

Duke u mbështetur në tiparet tektono – faciale, në zonën e Kraste - Cukalit janë dalluar: nënzona e Cukalit, njësia e Lisnë - Spitenit dhe nënzona e Krastës, së bashku me njësinë e Okshtunit. Më në lindje veçohet njësia e Ostrenit.

Nën-zona e Krastës. Përbën një nënzona paleogeografike lindore të zonës së Krasta - Cukalit. Ka përhapje sipërfaqësore në trajtën e një rripi kryesisht të ngushtë, por me sektorë ku zgjerohet dalja e saj si në Qaf-Shtamë-Xibër, Qaf Mollë-Polis, ndërsa prej rajoneve të masivit ultrabazik të Devollit e drejt jugut ka formën e një brezi të gjerë dhe duke u ngushtuar mjaft në afërsi të Leskovikut nga mbulimi i ofioliteve të zonës së Mirditës.

Në ndërtimin gjeologjik të kësaj nënzona marrin pjesë kryesisht depozitimet pelagjike, duke filluar nga ato të flishit të hershëm kryesisht të Albanit, gëlqerorët me globotrunkana të Kretakut të sipërm dhe flishit të ri të Maastriktian-Eocenit, që njëkohësisht pasqyrojnë edhe fizionomin tektonike të saj, duke formuar rrudhosje e struktura të ngushta, të përmbysura e të shtrira, të ndërlikuara nga shkëputje tektonike mbihypëse deri në luspore.

Në perëndim kjo nënzona mbulon sektorë të gjerë të zonës së Krujës. Në ballin e mbihipjes takohet një zonë e gjerë e luspëzuar dhe shkatërruar. Karakteristikë për këtë nënzona është se strukturat perëndimore (të ballit të nënzonës) në bërthamë të antiklinaleve ndërtohen nga flishi i hershëm ngjyrë gri i Albanit. Në strukturat antiklinale me zhvillim më të gjerë, zhvillohen rrudhosje dytësore të formave të ndryshme si monoklinale, sinklinale, hunda strukturale, gjuhë sinklinale siç janë antiklinori Shëngjergj-Prull, antiklinori Mner i sipërm, antiklinori Feken-Fagut, etj. Gjithashtu e veçanta e buzës perëndimore të kësaj nënzona janë

dhe prania e strukturave me ndërtim të theksuar të tektonikës shkëputëse luspore, deri gati të mbivendosur njëra mbi tjetrën siç janë ngritjet luspore të Mnerit të sipërm, ngritjet luspore të Kores, etj.

Në pjesën më lindore të kesaj nënzone zhvishen struktura antiklinore me rrudhosje e struktura të ngushta e të zgjatura antiklinale me bërthamë tavanin e flishit të hershëm dhe kryesisht gëlqerorët globotrunkanike dhe flishin e ri. Në mjaft nga këto struktura flishi i ri vendoset me pushim mbi gëlqerorët me globotrunkana. Konturet më të plota të strukturave dallohen në bazën e flishit paleogjenik (në rajonet ku është kryer rilevimi gjeologjik i detajuar) siç janë antiklinori Mal Mner-Papat, antiklinori Ostrovic-Vërisë, antiklinori Griqan-Labinot i sipërm e struktura të tjera. E përgjithshmja e strukturave është shtrirja meridionale e tyre, por që dallohen edhe shtrirje gjerësore siç janë ato të Griqan-Labinot i sipërm, Krastë e Madhe-Xibrakë që kanë prirje drejt verilindjes.

Në nënzonën e Krastës tektonika shkëputëse jo vetëm që është e pranishme, por dhe e shumëllojshme e tipëzuar nga shkëputjet tektonike normale afër vertikale e deri të komplikuar nga larttrëshqitje, mbihypje, mbulesa, shkëputje tektonike lule, etj., si dhe kombinime të tyre që janë tipike të regjimit tektonik në shtypje dhe që janë të lidhura me praninë në strukturat që ndërtojnë nënzonën e Krastës të depozitimeve terrigjene flishore-flishoidale, argjilito-mergelore të flishit të hershëm e të vonshëm, të cilat falë vetive duktile e nën presionet në shtypje të masave më lindore janë të prirura për të lëvizur, duke ndikuar ndjeshëm si në formimin ashtu dhe në coptimin e strukturave, duke na dhënë pamjen që kemi sot.

Për nënzonën e Krastës vihet re se rajonet më perëndimore të saj kanë dëndësi më të madhe shkëputjesh tektonike në krahasim me rajonet lindore të saj. Tektonika shkëputëse e rajoneve perëndimore në përgjithësi paraqitet gjatësore, duke këputur krahët perëndimore të strukturave. Ato janë shkëputje tektonike, normale, lartëshqitje etj., vijëdrejtë dhe vijëlakuar, me orientim të përgjithshëm gjatësor ose dinarik. Në disa rajone apo dhe struktura ato bëhen mbihypëse, duke mbuluar edhe pjesë të vetë strukturës deri në gati luspa njëra mbi tjetrën. Këto shkëputje tektonike në përgjithësi pranë buzës perëndimore bëhen shkëputje tektonike përshtjelluese të një grupi strukturash, të nënzonës dhe marrin karakter mbulesor. Tipike është shariazhimi i nënzonës së Krastës mbi zonën e Krujës, ku dallohet qartë mbetja tektonike e Lleshanit. Gjithashtu në anën lindore të nënzonës së Krastës mbivendosen tektonikisht shkëmbinjtë e zonës tektonike të Mirditës, ku në varësi të amplitudës së zhvendosjeve dhe ondulimit të rafshit tektonik, veprimtarisë erozive, pranisë së thyerjeve tërthore varet dhe zhveshmëria e nënzonës së Krastës në sipërfaqe.

4. SIZMICITETI

Shqipëria ka një pozicion gjeografik në pjesën perëndimore të Ballkanit dhe në veri-lindje të detit Mesdhe. Deti Mesdhe dhe gjithë shtrirja tokësore në drejtimin lindor dhe perëndimor përfshihet në brezin Mesdhetar të globit me aktivitet sizmik në funksion të zhvillimeve neotektonike të strukturës gjeosinklinale të kores së tokës. Studimet e kryera nga Instituti i Sizmologjisë të vendit tonë kanë treguar se vatrat e termeteve që prekin territorin shqiptar, ndodhen në zonat e kufijve midis plakës Afrikane dhe asaj Euro-Aziate.

4.1 Parametrat e projektimit në zonën e ndërtimit

